



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 941/3 prot.

Elbasan, më 29.9.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.76 dt.29.08.2025 “Për miratimin e varrezave publike të lagjes “Balliu”, në pasurinë nr.133/28 ZK 1652, Nj.A. Orenjë, Bashkia Librazhd”, si dhe pasi u njohëm me të dhënat sqaruese, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 87/1 prot.

Elbasan, më 9/9.2025

Lënda: / Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, përpara se të shprehemi për ligjshmërinë e aktit tuaj nr.76 dt.29.08.2025 “Për miratimin e varrezave publike të lagjes “Balliu”, në pasurinë nr.133/28, Z K 1652, Njësia Administrative Orenjë, Bashkia Lirazhd“, ju bëjmë me dije se lidhur me këtë vendim tuajin ka paraqitur një ankesë z. Ferit Balliu (bashkëngjitur një kopje), i cili e kundërshton këtë vendim pasi pretendon se varrezat janë miratuar të ndërtohen ngjitur me pronën dhe banesën e tij duke i shkaktuar dëm emocional.

Sa më sipër, përpara se shprehemi për aktin në fjalë, kërkojmë:

- Të shqyrtohet ankesa e z. Ferit Balliu dhe të na informoni lidhur me çfarë do të konkludoni lidhur me pretendimet e tij
- Të na sqaroni a janë respektuar përcaktimet e nenit 4 të ligjit nr.9220 datë 15.04.2004 “Për shërbimin publik të varrimit”?

Deri në dërgimin e të dhënave akti juaj mbetet i pakonfirmuar.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD
KESHILLI BASHKIAK

Nr 6406 Prot.

Librazhd, 19.09.2025

LËNDA : Mbi ligjshmërinë e aktit nr.76, datë 29.08.2025

DREJTUAR : PREFEKTIT TË QARKUT ELBASAN

Të nderuar,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.971/1 prot, datë 09.09.2025 ju informojmë si më poshtë vijon :

Varrezat publike të lagjes Balliu miratohen në pasurinë publike nr.133/28, ZK 1652 ku ka varre shumë të vjetra. Ju sqarojmë se varrezat sipas ligjit nr.9220, datë 15.04.2004 “Për shërbimin publik të varrimit” të ndryshuar janë varreza publike dhe jo private.

Përsa më sipër duke qenë se varrezat publike janë të hershmë dhe ka varre ekzistuese, në respektim të ligjit nr.9220, datë 15.04.2004 “Për shërbimin publik të varrimit” të ndryshuar, është vendosur miratimi nga Këshilli Bashkiak sipas të gjitha parashikimeve ligjore.

Falemindërit për mirëkuptimin,

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ELSON MALLUTA





941
03.09.2025
REKLA E SHQIPËRISE
REKTI QARKU

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA LIBRAZHD
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.02.09.2025

Nr.5917 prot

Nr.76 dt.29.08.2025

"PËR MIRATIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË LAGJES BALLIU, NË PASURINË NR.133/28, ZK. 1652, NJ.AD. ORENJË, BASHKIA LIBRAZHD"

Në mbështetje ligjit Nr .9220, date 15.4.2004, nenit 4 dhe nenit 8 të akteve ligjore për administrimin dhe funksionimin e varrezave publike, si dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Planifikimit, kontrollit të territorit dhe pronës. Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me datë 29.08.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

V E N D O S I:

1. Të miratojë pasurinë me nr. 133/28, si Varrezë Publike në Z.K. 1652 Lagja Balliu, Nj. Ad. Orenjë Bashkia Librazhd.
2. Ngarkohen sektorët e mëposhtëm për ndjekjen e procedurave të mëtejshme ligjore:
 - Drejtoria e Shërbimeve Publike
 - Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Pronës
 - Drejtoria e Buxhetit Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social
3. Ky Projekt-vendim hyn ne fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU



P/Vendimi
Nr. 1 @ ndryshime



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD

PROJEKT-VENDIM

Nr. ___ Datë __. __. 2025

**"PËR MIRATIMIN E VARREZAVE PUBLIKE TË LAGJES BALLIU, NË PASURINË
NR.133/28, ZK. 1652, NJ.AD. ORENJË, BASHKIA LIBRAZHD"**

Në mbështetje ligjit Nr .9220, date 15.4.2004, nenit 4 dhe nenit 8 të akteve ligjore për administrimin dhe funksionimin e varrezave publike, si dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Planifikimit, kontrollit të territorit dhe pronës. Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me datë . . 2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

V E N D O S I:

1. Të miratojë pasurinë me nr. 133/28, si Varrezë Publike në Z.K. 1652 Lagja Balliu, Nj. Ad. Orenjë Bashkia Librazhd.
2. Ngarkohen sektorët e mëposhtëm për ndjekjen e procedurave të mëtejshme ligjore:
 - Drejtoria e Shërbimeve Publike
 - Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Pronës
 - Drejtoria e Buxhetit Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social
3. Ky Projekt-vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË

Mariglen Disha

RELACION SHPJEGUES

Lënda: Për miratimin e varrezave publike të lagjes "Balliu", pasuria nr. 133/28, Z.K. 1652, Njësia Administrative Orenjë, Bashkia Librazhd.

Në zbatim të ligjit nr. 9220, datë 15.04.2004 "Për varrezat", si dhe ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Bashkia Librazhd, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, ka shqyrtuar nevojën për sistemimin dhe miratimin e një varreze publike në lagjen Balliu, Nj.A. Orenjë.

Pas verifikimeve të kryera nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Territorit dhe Pronës, u evidentua se pasuria me nr. 133/28, Z.K. 1652, plotëson kriteret ligjore dhe teknike për t'u përcaktuar si truall për varrezë publike.


Kjo ndërhyrje është e domosdoshme për:

- Krijimin e një hapësire të dedikuar dhe të mirëadministruar për varreza publike, në përputhje me standardet ligjore dhe sanitare;
- Përbushjen e kërkesave të komunitetit të lagjes Balliu dhe Njesisë Administrative Orenjë;
- Sigurimin e administrimit, mirëmbajtjes dhe funksionimit sipas legjislacionit në fuqi;
- Parandalimin e përdorimit të paorganizuar dhe të paautorizuar të truallit për qëllime varrimi.

Duke qenë se terreni i përcaktuar është pjesë e pasurisë nr. 133/28, Z.K. 1652, dhe është i përshtatshëm për këtë funksion publik, propozimi i miratimit nga Këshilli Bashkiak është i justifikuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

Për këto arsye, propozohet miratimi i pasurisë nr. 133/28, Z.K. 1652 si Varrezë Publike për lagjen Balliu, Njësia Administrative Orenjë, Bashkia Librazhd.

Punoi: Ing. Enri Gjura



SEKRETARI
PËR PËRGJITHSHËM

EA/6
01.08.2025

5185
DT 31.07.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

Uabaneshtiky

DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

~~LIBRAZHID~~

Nr. 196 Prot.

Librazhd me 30.07.2025

Lenda : Per miratimin e nje siperfaqe toke si varreze publike ne lagjen Balliu , Njesia Orenje

Drejtuar: Bashkise Librazhd

z. Bajram Pishkashi

Sekretar I Pergjithshem

Prane institucionit tone eshte paraqitur shkresa Nr. 196 Date 29.07.2025 , nga z. Hysni Balliu , banor I njesise administrative Orenje per ndjekjen e procedurave per miratimin e nje siperfaqeje toke si varreze publike . Bashkengjitur kesaj kerkese jane parqitur hartat e vendndodhjes se kesaj siperfaqe dhe vertetime nga Z.A.M.T Qarku Elbasan dhe nga Zyra Vendore Librazhd

Institucioni qe une drejtoj ka ne misionin dhe objektivat , te ruaje dhe mirmbaje siperfaqet e varrezave publike dhe te parashikoje investime te vazhdueshme per permirsimin e infrastruktures se tyre dhe zgjerimin e siperfaqeve te varrezave.

Duke qene se miratimi I siperfaqeve te varrezave publike eshte nje procedure qe kalon nepermjet keshillit Bashkiak , kerkojme nga ana juaj trajtimin e kesaj ceshtje , ne menyre qe ti vijme ne ndihme komunitetit te kesaj zone .

Duke ju falenderuar per bashkepunimin!

Drejtor

Agron GEGA



KËRKESË PËRCJELLËSE PËR NDJEKJEN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Drejtuar: Z. Mariglen Disha

Kryetar i Bashkisë Librazhd

Lënda: Kërkesë për ndjekjen e procedurës për miratimin e një sipërfaqeje si varrezë publike

I nderuar Z. Kryetar,

Në vijim të kërkesës sime të mëparshme drejtuar Bashkisë Librazhd, lidhur me miratimin e një sipërfaqeje prej 1000 m², e ndodhur në lagjen "Balliu", fshati Funarës, Njësia Administrative Orenjë, si truall për varrezë publike, ju lutem që kjo çështje të trajtohet konform procedurave ligjore dhe administrative në fuqi.

Pronësia në fjalë i referohet pasurisë nr. 133/28, zona kadastrale 1652, dhe ka shërbyer tradicionalisht si vend varrimi për komunitetin lokal të lagjes "Balliu".

Në përputhje me nenin 54 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27.05.2020, kërkoj që kjo kërkesë të përfshihet në rendin e ditës të mbledhjes së ardhshme të Këshillit Bashkiak, me qëllim ndjekjen dhe përmbylljen e të gjitha hapave ligjorë për miratimin zyrtar të kësaj sipërfaqeje si varrezë publike.

Bashkëngjitur kësaj kërkesë janë dokumente që vërtetojnë se kjo sipërfaqe ka shërbyer si varrezë publike përpara dhe pas viteve '90. Ajo është pronë shtetërore dhe nuk është trajtuar me ligjin nr. 7501, duke ruajtur funksionin tradicional në shërbim të komunitetit.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

Me respekt,

Hysne Balliu

Lagjja "Balliu", Fshati Funarës

Njësia Administrative Orenjë

☎ 0696110578

📅 16.07.2025

D. 28.07.2025

KËRKESË PËRCJELLËSE PËR TRAJTIMIN E NJË SIPËRFAQEJE SI VARREZË PUBLIKE

Drejtuar: Bashkisë Librazhd

Nëpërmjet: Njesisë Administrative Orenjë

I nderuar Z. Kryetar,

Në cilësinë e banorit të fshatit Funares, Njësia Administrative Orenjë, ju drejtohem me këtë kërkesë për trajtimin e çështjes së përcaktimit dhe miratimit të një sipërfaqeje toke si varrezë publike, konform legjislacionit dhe procedurave ligjore në fuqi.

Bëhet fjalë për pasurinë me nr. 133/28, zona kadastrale 1652, e cila ndodhet në territorin e fshatit Funares. Kjo sipërfaqe ka shërbyer tradicionalisht si vend varrimi për komunitetin lokal, në veçanti për banorët e lagjes "Balliu".

Pronësia në fjalë është shtetërore dhe nuk është trajtuar në kuadër të ligjit nr. 7501, çka nënkupton se ajo ka ruajtur funksionin e saj publik ndër vite, duke shërbyer si vend varrimi si përpara ashtu edhe pas viteve 1990.

Bashkëngjitur kësaj kërkesë gjenden dokumente që vërtetojnë historikun dhe funksionin publik të kësaj prone, si dhe dëshmi të përdorimit të saj nga komuniteti.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, mbetem në pritje të trajtimit të kësaj çështjeje nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Librazhd.

Me respekt,

Bastri Luka

Funares, Njësia Administrative Orenjë



Legjenda
Parcelat.

Ortofoto 2015
20 cm



Shtresë
Bazë




Ndërtesat



Rendi 3 (Kufi
Bashki)

Rendi 2 (Kufi
Qarku)



IRISË
BASAN

Datë 09 / 01 / 20 95

VERTETIM
(Shoqëruar me hartë kadastrale)

00660

se parcela qe ndodhet në territorin e fshatit Funarës njësia
ie / Libradhd figuron në librat kadastrale si tokë buall e pabujtshme
sipas dokumentacionit qe disponon Z.A.M.T-ja 516107/101
ale/skematike ne shkallën 1:5000 për parcelën në fjalë
ërkesën e të interesuarit.

1000

Çmimi 1 000 leke



Drejtori i D.A.M.T-së në Qark